



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 17/2015

Prishtinë, më 28.4.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Enver Hoti dhe Duda Balje-anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Blerim Grainca dhe Pal Lekaj - anëtarë.

Pjesëmarrës të ftuar: Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik; Adnan Merovci, kryetar i Bordit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Ekrem Hoxha, kryetar i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Pjesëmarrës të tjerë: Besa Zogaj- Gashi zv.ministre, Agim Kukaj, Marcelë Restelica dhe Enver Basha- MZHE; Naile Krasniqi- KPM; Visar Halimi- ARKEP; Dardan Abazi – INDEP; Valmire Hoti- INFODIREKT.TV; Dukagjin Maliqi- TV RROKUM; Adelinë Sahiti- KOSOVAPRESS; Valdete Berisha-Kosova Sot; Arta Xhylani, Arbana Pireva, Blendina Krasniqi dhe Besa Berisha – UNDP (praktikantë).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.4.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.4.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 21.4.2015, u miratua me këtë plotësim nga anëtari i Komisionit, z. Raif Qela, i cili tha se duhet që në pikën e tretë të rendit të ditës, të shtohet ky tekst: “Raporti vjetor i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, i cili e rendit Kosovën të parën në rajon për nga progresi në përmbushjen e kërkesave legislative në këtë fushë, është edhe një dëshmi e punës së mirë që ka bërë AAC-ja, me nxjerrjen e akteve nënligjore e rregulloreve të nevojshme”.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se sot kemi në rend dite shqyrtimin në parim të Projektligjit nr. 05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, pasi që për këtë projektligj është sponsor Ministra e Zhvillimit Ekonomik, prandaj e kemi ftuar këtu ministrin, z. Stavileci për të dhënë arsyetimin e tij për këtë projektligj. Pastaj, fjalën ia dha për të paraqitur ekspozenë për projektligjin.

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), në ekspozenë e tij tha se me Projektligjin për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, përcaktohen kushtet operative të mediave. Ky projektligj, rregullon metodën dhe kushtet për transmetimet radio difuzive tokësore digjitale, procedurën për kalimin nga transmetimet radio difuzive analoge në ato digjitale dhe çështjet tjera të rëndësishme për transmetimet radio difuzive digjitale, siç janë: planifikimi, zhvillimi dhe shfrytëzimi i rrjeteve dhe e drejta për qasje në multipleks për emetim digjital tokësor, obligimet e operatorëve të rrjetit dhe operatorëve të multipleksit, menaxhimi i multipleksit, periudha e kalimit, masat stimuluese për konsumatorë, të drejtat dhe obligimet për të shfrytëzuar radio-frekuencat, dispozitat e veçanta mbi bartjen e së drejtës për shfrytëzim të radio-frekuencave për multipleks, kufizimet operative të multipleksit. Ai theksoi se qëllimi i këtij projektligji është që të rregullojë procesin kalues nga emetimi analog, në atë digjital në Republikën e Kosovës, i cili sipas Konkluzioneve të Konferencës Rajonale Radio-komunikuese (RRC06), të ITU-së, do të duhej të përfundonte deri më 17 qershor 2015, të përcaktojë kushtet për zbatimin e transmetimeve radio difuzive tokësore digjitale, të përcaktojë të drejtat dhe obligimet e operatorëve të rrjeteve, operatorëve të multipleksëve dhe ofruesve të shërbimeve mediale, ndryshimet në menaxhimin e brezit radio frekuencor, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin efikas të brezit radio frekuencor, i cili në pajtim me aktet juridike nacionale dhe ndërkombëtare, është i paraparë për emetimin e programeve radiotelevizive, përmes opsioneve teknologjike në dispozicion. Gjithashtu, z. Stavileci theksoi se një ndër objektivat që MZHE-ja ka paraparë në Planin e Veprimit për Partneritet Evropian, është edhe inicimi i hartimit të Projektligjit për Digjitalizim. Po ashtu, theksoi se draft-strategjia e kalimit nga teknologjia transmetuese analoge, në atë digjitale për Republikën e Kosovës, e cila parasheh që procesi i përpilimit të këtij projektligji do të udhëhiqet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si ministri përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e komunikimeve elektronike.

Kryetari, po ashtu, tha se për këtë çështje e kemi të ftuar edhe z. Adnan Merovci, kryetar i Bordit të Komisionit të Pavarur për Media dhe z. Ekrem Hoxha, kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Më pas, fjalën ia dha z. Merovci.

Adnan Merovci, kryetar i Bordit të Komisionit të Pavarur për Media, tha se këtu është në cilësi të përfaqësuesit të kryetarit të rregullatorit të mediave, që është në njëfarë mënyre, autor i Strategjisë për digjitalizim, e cila ka filluar vite më parë, ku është harmonizuar, është diskutuar e përshtatur, dhe jo rastësisht, është quajtur strategji, sepse duhet t'i dedikohet Kosovës dhe interesave të Kosovës. Theksoi se Strategjia për digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, është dorëzuar zyrtarisht në Qeveri dhe ua kemi dërguar palëve të interesit, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Komisionit tuaj, pra ua kemi dërguar kopjet dhe janë publike tani. Kanë kaluar pesëmbëdhjetë ditë pune dhe supozohet se ai tekst i Strategjisë, në një mënyrë, është pranuar edhe formalisht nga Qeveria, në bazë të cilit draftohet ligji, i cili në këtë rast, dallon prej ligjeve të tjera në përgjithësi, sepse pak a shumë është një ligj teknik që parasheh vetëm implementimin e digjitalizimit, si modul që përfshihen krejt modulet e tjera të strategjisë. Strategjia është një udhërrëfyes i këtij aktiviteti që nuk është më vetëm dëshirë, por është detyrim ndërkombëtar. Z. Merovci, paraqiti disa çështje që duhet të jenë gjatë fazës së shqyrtimit në Projektligjin për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, siç janë këto propozime: çështja e parë, projektligji parasheh procedurën e tenderit, pak a shumë, ju e dini se e kemi Ligjin për prokurim publik që është i zbatueshëm, por këtu, bazuar në Strategjinë, ne i kemi improvizuar dy faza. Krejt këtë e kemi bërë për shkak të mosarritjes së datës 17 qershor 2015. Megjithatë, kjo datë nuk është fundi i botës, sepse për ne është dashur që të jetë datë. Ne, edhe pse teorikisht e themi dhe nuk e arrijmë, bile së paku të pretendojmë dhe të bëjmë maksimumin, por jo t'i lejojmë vetes të bëjmë lëshime, të cilat nesër mund të na kushtojnë. Gjëja e parë që në ligj është në shpërputhje, është çështje teknike. Pra, është përfshirja e operatorëve rajonalë në multipleksët nacionalë, gjë që nuk është teknikisht e mundur, sepse forma e transmetimit që është zgjedhur nga njësitë tona teknike dhe kjo nuk është bërë me dëshirë, por me nevojë që është zgjedhur sistemi i rrjetës që është më racionale dhe më së shumti i përgjigjet Kosovës e ashtuquajtur "Single Frequency Network" (SFN), që shfrytëzon frekuenca më pak dhe është më racionale. Zgjedhja është që njëkohësisht në pjesën e parë të tenderimit të multipleksëve nacionalë, njëkohësisht, të hyhet edhe në tenderimin e multipleksëve rajonalë që të fitojmë kohë që edhe mediat rajonale të përfshihen, sepse ne jemi dëshmitarë të shumë takimeve të mëdha ku kryesisht faktori ndërkombëtar është i pashmangshëm në krejt këtë proces. Insistimet më të mëdha, janë në aspektin rajonal dhe lokal. Kur them rajonal, gjithherë kuptomëni edhe lokal, sepse pak a shumë janë të përfshira në dy palë. Çështje e dytë, është çështja e fazës së parë d.m.th që në projektligj nuk thuhet asnjë fjalë rreth njëkohshmërisë. D.m.th. në fazën e parë duhet të përfshihet çështja e dhënies me automatizëm edhe të një multipleksi të transmetuesit publik, i cili është i paraparë në Strategji si një posedues dhe këtu nuk duhet që ta pengojmë proceduralisht dhe ligji mos të thotë një fjalë që kjo fillon njëkohësisht, sepse ne i detyrohem tani me ligj. Jemi autoritet që i atribuojmë një multipleks RTK-së, në këtë rast, por nuk mund ta bëjmë këtë pa e paraparë ligji dhe kjo është çështje pak a shumë teknike, por jo edhe problematike. Dhe, çështja tjetër, është që njëkohësisht të jetë përfshirja e transmetuesve rajonalë, që mos të humbim kohë, sepse çështja e përfshirjes së operatorëve rajonalë në MUKSA nacional, ka qenë ide sikur të ishte arritur implementimi i digjitalizimit një vit apo dy vite më parë, ku kemi pasur kohë për këto gjëra. Çështja e tretë, theksoi se është çështja e fazës së dytë që ne e kemi paraparë dhe kryesisht e ashtuquajtura fazë komerciale. Sepse, ne duhet ta dimë që kemi paraparë komponentin komercial në këtë proces, për t'i inkurajuar investitorët e huaj për ta arritur konkurrencën dhe për t'i përmbushur disa parakushte edhe të direktivave të Komisionit Evropian, por megjithatë mos ta dëmtojmë industrinë aktuale, në këtë rast, televizionet rajonale dhe televizionet nacionale, ku i kemi paraparë në një periudhë të ashtuquajtur, nëse atje ka qenë komerciale, kjo të quhet "beauty contest". Në këtë rast, kemi konsultuar edhe ligjet për prokurim edhe ligjet për koncensionim. Megjithatë, për këto frekuenca, fjala më adekuate është koncensionim i tyre, duke qenë si e mirë kombëtare, në asnjë moment shitjeje, faljeje ose atribuum, është koncensionim. Dhe, ligji për koncensionime, ekziston. Në përputhje me të, i kemi paraparë këto gjëra. Kjo bëhet për shkak të mbrojtjes së interesit të industrisë aktuale, gjë që në një mënyrë ose në tjetrën, rajoni e ka bërë, por nuk e ka bërë mirë. Ne kemi qenë në përparësi,

sepse nga rajoni kemi mësuar si duhet të punojmë, sepse digjitalizimi pothuajse në shumë aspekte ka dështuar dhe kemi qenë shumë të udhëzuar nga ata që të mos i bëjmë gabimet e njëjta. Çështja e katërt, theksoi se është çështja e vetë ligjit që i parasheh procedurat e tenderimit dhe janë në dy komisione. Pra, është komisioni mbikëqyrës dhe komisioni vlerësues. Kompozicioni i këtij komisioni është gjithëherë 2+2+1; dy nga KPM-ja, dy nga ARKEP-i dhe një nga Qeveria. Po ashtu, tha se nuk kanë pretendim në monopol të këtij procesi të digjitalizimit dhe as për kompetenca, por thjesht për shkak të përgjegjësisë, mendojmë që na është bërë një e padrejtë e vogël, po këtu duhet të kuptohemi drejt dhe fundi i fundit kjo është një kërkesë e KPM-së. Propozoi që të jetë në cilësinë e të parëve, në mes të barabartëve, numri i pjesëmarrësve të KMP-së, si hartues, kujdestar dhe implementues i krejt këtij procesi. Pra, ta kemi përgjegjësinë, jo kompetencën e marrjes së vendimeve, që një anëtar nga ARKEP-i të na atribuohet neve që të jetë 3+3+1. Kështu siç është, në një rast, votat e barabarta ndahen nga Ministria, sepse kryesohet njëri komision nga Ministria dhe ky është komisioni mbikëqyrës dhe tjetri është vlerësues. Ne jemi rregullator, jemi të pavarur dhe kategori kushtetuese. Në fund, kërkoi që të ceken në procesverbal të gjitha këto çështje që ngrihen, në tërë tekstin e Projektligjit për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, për t'i rikujtuar d.m.th. aranzhuesit që ligji të përfshijë tërë implementimin, këtë nuk guxojmë të lejojmë, sepse kjo është shumë me rendësi dhe mendoj se ndaj mendimin e të gjithëve që ligji nuk guxon të mos përfshijë implementimin e digjitalizimit në tërësi, sepse do të vijmë në një situatë, saqë nëse nuk themi në një nen këtu të fundit, pra që ky ligj që parasheh të gjitha fazat, edhe pse aty është çështja e afatit, iu ka atribuuar KPM-së. Atëherë do të detyrohemi që ta hartojmë edhe një ligj në fazën e dytë, që është një humbje kohe dhe një "non sense". Për këtë që po e them, kam qenë i sugjeruar nga një konsulent ndërkombëtar, i cili ka thënë se definitivisht duhet të keni kujdes, se jo rrallëherë mundeni, për shkak të ndonjë gabimi pa dashje, të na rrjedhë kjo. Meqenëse është në dy faza implementimi, quhet faza e parë edhe faza e dytë.

Kryetari, tha se ajo që na intereson tani nga përfaqësuesi i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, është nga aspekti i telekomunikimeve dhe kërkoi që të jetë më konkret se në cilat nene nuk pajtohet ARKEP-i.

Ekrem Hoxha, kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, tha se ARKEP-i gjatë hartimit të Projektligjit për digjitalizim të transmetimeve radio difuzive tokësore, ka marrë pjesë në mënyrë aktive në grupin e punës. Ai theksoi se nuk kemi vërejtje substanciale në projektligj, por nuk jemi pajtuar për tri nene lidhur me afatet që duhet t'i japë KPM-ja, prej tre muajve për dividendin digjital, resurset digjitale dhe për mbrojtjen e kanaleve. Lidhur me këto tri çështje që rregullohen me nenet 4, 12 dhe 16, për të cilat tha se janë shqetësim nga ARKEP-i, do t'i dërgojmë rekomandimet me shkrim.

Kryetari, parashitroi disa pyetje: A duhet të jetë 17 qershori i vitit 2015, koha e fundit që Projektligji për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, i aprovuar nga Kuvendi dhe sa jeni të gatshëm t'i eviton pasojat e vonësës të mosmiratimit? Kalimi në digjitalizim, a i rrezikon frekuencat e hapësirës të operimit të transmetuesit publik-RTK-së? Kushtet e tenderimit publik në nenin 14, si do t'i trajtoni? Sepse, këtu flitet që frekuencat mund të jepen me qira. Lidhur me çështjen e multipleksit, pra që mos të paguhet, kërkoi sqarim.

Raif Qela, kërkoi që të procedohet sa më shpejt Projektligji për Digjitalizim transmetimeve radio difuzive tokësore, për shkak të detyrimeve ndërkombëtare që duhet të rregullohet kjo fushë me anë të ligjit. Pyetje lidhur për mbulueshmërinë e transmetuesve se sa kanë drejtë operatorët, në këtë rast, transmetuesit e TV-ve lokale, siç është TV Mitrovica, të shtrijnë rrjetin e shikueshmërisë. Ndërsa, për nenin 12 që ka të bëjë me masat stimuluese për konsumatorët, tha se këto masa stimuluese janë shumë të mira dhe të favorshme për operatorët.

Besim Beqaj, tha se Projektligji për digjitalizim transmetimeve radio difuzive tokësore është duke u trajtuar gjatë, por për dallimet që po dalin tani në mes të MZHE-së, KPM-së dhe ARKEP- it, iu kërkoi që këto propozime që i kanë, t'i dorëzojnë me shkrim gjatë fazës së amendamentimit të projektligjit, pasi që ka mjaft kohë në mes të dy leximeve. Ndërsa, propozoi që Komisioni ta angazhojë një ekspert të kësaj fushe, gjatë shqyrtimit të projektligjit në fjalë.

Adnan Merovci, kryetar i Bordit të Komisionit të Pavarur për Media, iu përgjigj disa pyetjeve të parashtruara, pra për datën 17 qershor që duhet të miratohet projektligji, tha se është një datë që duhet të mbyllet transmetimi analog, për të kaluar në atë digjital. Për këtë kërkoi që sa më shpejt të miratohet projektligji, pasi që ka mbetur shumë pak kohë. Për dy multipleksët, tha se i kemi tri, por ka mundësi edhe për një tjetër. Tha se i kemi propozuar Qeverisë që të investojë në këtë teknikë, por Qeveria na ka thënë se nuk ka mjete financiar të investojë në këtë teknikë. Lidhur me strategjinë që e ka hartuar KPM-ja, tha se është dashur që t'i paraprijë Projektligjit për digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore. Për çështjen e TV Mitrovicës, tha që po dëgjohet deri në Kaçanik dhe mënyra e operimit është e jashtëligjshme, sepse është vetëm TV lokal. Për dallimet në mes MZHE-së, KPM-së, tha se janë vetëm për çështje teknike. Ndërsa, faza e parë e kalimit nga transmetimi analog në digjital, do të jetë vetëm testimi.

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), sa i përket afatit 17 qershor, që të miratohet Projektligji për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, kërkoi nga Komisioni që t'i përshpejtojë procedurat e miratimit. Ndërsa, sa i përket dallimeve në mes të MZHE-së dhe KPM-së, tha se duhet të gjendet një balancim në mes të interesave të shtetit, operueseve ekonomikë dhe interesave të qytetarëve.

Agim Kukaj, përfaqësuese nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, tha se Projektligji për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, është zgjedhje e fundit, pasi që Qeveria nuk ka mundësi të investojë në këtë fushë. Theksoi se në bazë të projektligjit në fjalë, TV-ve me transmetim nacional, iu rregullohet në këtë mënyrë transmetimi, pra RTK-së, si transmetues publik, i ndahet një multipleks, ndërsa KTV-së dhe TV-21, iu ndahet vetëm koha transmetimit.

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se nga ky takim dolën edhe disa dilema, siç janë interesi nacional, ekonomik dhe qytetar, prandaj ne si Komision, gjatë shqyrtimit edhe në grupin e punës, do t'i kemi parasysh të gjitha dilemat dhe çështjet që u ngritën. Ndërsa, në fund të diskutimeve, propozoi që të formohet grupi i punës prej tre anëtarëve dhe në këtë grup të punës të përfshihen edhe anëtarë nga Komisioni funksional që e mbulon fushën e mediave.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr .05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore.

Komisioni vendosi që grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë përbërje: Raif Qela, kryesues, Blerim Grainca dhe Enver Hoti, anëtarë.

4. Të ndryshme

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, njoftoi Komisionin lidhur me kërkesën që i ka bërë Komisionit për Legjislacion, që të mbahet mbledhje e përbashkët, lidhur me kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata.

Komisioni mbështeti propozimin e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa